



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 050/2021

Nr. Protokolli:70/2021

Për:	AGE group SH.P.K., Avdullah Bugari p.n, 21000, Rahovec
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	17.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 12.05.2021, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: AGE group SH.P.K., Avdullah Bugari p.n, 21000, Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF-së në Mushtisht” me Nr. të Prokurimi: 624-21-1338-5-2-1 & 624-21-59-521 -nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës 12.05.2021 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik:: AGE group SH.P.K., Avdullah Bugari p.n, 21000, Rahovec lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF-së në Mushtisht kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 07.05.2021 të publikuar në platformën elektronike.
2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 07.05.2021.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsy e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **12.05.2021**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF-së në Mushtisht** me Nr. të Prokurimi: **624-21-1338-5-2-1 & 624-21-59-521** -, kundër Njoftim per Vendimin e AK -së, të datës **07.05.2021** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe se pretendimet tuaja nuk qendrojnë, ngase ne ofertën tuaj te dorëzuar te kapaciteti teknik profesional mungon stafi teknik per kryerjen e ketij projekti, pra nuk e plotësoni këtë kërkesë të AK-Suharekë

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

